



KB

REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILI I BASHKISË

Nr. 1004 prot.

Vlorë, më 22.01 2024

Lënda: Informacion mbi raportin statistikor të punës dhe vendimarrjen e Këshillit të Bashkisë Vlorë për periudhën 1 janar- 31 dhjetor 2023.

KËSHILLIT TË BASHKISË

Bazuar në Rregulloren “ Për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë” Neni 111, pika 3, në funksion të transparencës së vendimarrjes së Këshillit të Bashkisë, paraqesim këtë informacion për punën dhe vendimarrjen e Këshillit të Bashkisë për vitin 2023.

Paraprakisht theksojmë se, gjatë vitit 2023 Këshilli i Bashkisë gjatë procesit të vendimarrjes, për periudhën raportuese nëpërmjet pyetjeve dhe diskutimeve në komisionet e përhershme si, dhe në mbledhjet e radhës ose në mbledhjet jashtë radhe, të zhvilluara me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë ,ka synuar ti përgjigjet detyrimeve që ka Bashkia si institucion i Vetëqeverisjes Vendore.

Si rregull mbledhjet e Këshillit janë zhvilluar rregullisht çdo muaj duke respektuar procedurat e parashikuara ligjore si edhe ato në Rregulloren e Këshillit. Në raste të veçanta janë zhvilluar edhe mbledhje jashtë radhe si ajo e datës 18.1.2023 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2023”, i cili nuk u miratua në dhjetor 2022 sikurse parashikohet në Ligjin Nr.68/2017 dt.27.4.2017 “Për Financat e Vetqeverisjes Vendore” ose mbledhja e datës 07.12.2023 për miratimin e Paketës Fiskale etj. Në total gjatë vitit 2023 janë zhvilluar 16 mbledhje të këshillit, nga të cilat 4 mbledhje jashtë radhe.

Në mbledhjet e Këshillit të cituara më lartë janë miratuar gjithësej 103 vendim,e objekti i të cilave ka qënë i ndryshëm në varësi të çështjeve të vlerësuara nga administrata e bashkisë,si të domosdoshme.

Duke qënë se viti 2023 ishte edhe viti i zgjedhjeve për Organet e Vetqeverisjes Vendore, një

pjesë e konsiderueshme, gjithësej 13 vendime lidhen me procedurat vendimarrëse për zgjedhjen e organeve drejtuese të Këshillit të Bashkisë si dhe të strukturave komunitare në fshatra, në juridiksionin e Bashkisë Vlorë. Është për tu përmendur fakti që, nga 103 vendime të Këshillit të Bashkisë, vetëm për një vendim, Prefekti i Qarkut Vlorë, nuk është shprehur pozitivisht për ligjshmërinë e tij.

Ishte pikërisht Vendimi Nr.29 dt.31.03.2023, “Për kalimin në pronësi të Tokës Bujqësore” të cilin Prefekti i Qarkut e vlerësoi të paligjshëm por, që edhe gjatë diskutimit në komisione pati vërejtje për procedurën.

Pavarësisht se është vetëm një vendim i tillë, për të cilin nuk është shprehur ligjshmëria nga Prefekti Qarkut, për të cilin në mbledhjen e radhës u korrigjuan mangësitë, dhe u shpreh i ligjshëm, duhet të shërbejë që, në vijmësi, të rritet përgjegjësia vendimarrëse në komisionet e përhershme qoftë me diskutime të argumentuara ,por veçanërisht me pjesëmarrjen e gjithë antarëve të komisioneve përkatëse.

Referuar tematikës së diskutuar dhe vendimarrjes së këshillit gjatë vitit 2023, fushat përkatëse të vendimeve janë si më poshtë:

- Vendime të cilat për procedurë kalojnë çdo muajnë mbledhje, që kanë të bëjnë me Ndihmën Ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë dhe nga Fondi i Kushtëzuar si, dhe procedurat përkatëse lidhur me kërkesat e përfitimit të saj.
- Ndërkohë janë disa vendime këshilli, lidhur me Emergjencat Civile dhe kryesisht me dëme materiale të banesave nga fatkeqësi të ndryshme, për banorët e Bashkisë Vlorë si, edhe për Rikonstruksionin e pallatit 1300,i cili është vlerësuar me probleme në strukturë nga Instituti i Ndërtimit.
- Vendime të rëndësishme të miratuara nga Këshilli i Bashkisë gjatë kësaj periudhe janë edhe ato që lidhen me miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2023 dhe 2024, si edhe ndryshime të Buxhetit të vitit 2023, referuar kërkesave dhe prioriteteve të administratës së bashkisë, të dala gjatë zbatimit të tij.

Sikurse cituam më lart, 13 vendime të këshillit lidhen me zgjedhjen e organeve drejtuese të këshillit , komisionet e përhershme, strukturat komunitare në fshat etj, të cilat u zgjedhën pas zgjedhjeve për Organet e Vetqeverisjes Vendore të vitit 2023.

- Janë gjithashtu edhe disa vendime të këshillit, të cilat kanë trajtuar çështjet e familjeve dhe fëmijëve, për familjet në nevojë lidhur me ristrukturimin e banesave, si dhe bonusin e qirasë.
- Gjatë kësaj periudhe, janë miratuar vendime për emërtim rruge të qytetit si dhe dhënie të titullit “Qytetar Nderi i Vlorës”, bazuar në propozimet e subjekteve të interesuara ose grupeve të këshilltareve.

- Veç sa më lartë janë miratuar edhe 25 vendime të tjera nga Këshilli i Bashkisë që kanë të bëjnë me kalim në pronësi të Tokës Bujqësore; me çështje të arsimit; numrin e punonjësve të bashkisë; Paketa Fiskale për vitin 2024; shërbimin pyjor; menaxhimin e mbetjeve; Ujësellsin e të tjera.

Në mënyrë të përmbledhur vendimarrja paraqitet si më poshtë:

Nr Rend	Objekti i Vendimarrjes	Numri Vendimeve
1.	Ndihma Ekonomike nga të ardhurat dhe fondi kushtëzuar	25
2.	Shpërblime në rast fatkeqësie natyrore	10
3.	Vendime lidhur me Buxhetin dhe ndryshimet si dhe PPA	16
4.	Vendime në ndihmë të familjeve dhe fëmijëve në nevojë	10
5.	Emërtime Rruge dhe Qytetar Nderi	9
6.	Zgjedhjet e organeve drejtuese të këshillit dhe strukturave Komunitare te Fshatrave	13
7.	Kalimi në pronësi i Tokës Bujqësore dhe Menaxhimi i Pyjeve	4
8.	Vendime lidhur me Ujësellsin dhe menaxhimin e mbetjeve	3
9.	Paketa Fiskale dhe numri punonjësve	4
10.	Vendime lidhur me sportin	4
11.	Të tjera	5

Në procesin e vendimarrjes, një rëndësi e veçantë i është kushtuar seancave të Këshillimit me bashkësinë (dëgjesave publike) sipas parashikimeve të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore “ Neni 18. si dhe në Rregulloren “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë”. Në çështjet që është kërkuar vendimarrje e Këshillit, për të cilat është i domosdoshëm konsultimi publik, Këshilli aktual i Bashkisë ka organizuar konsultime për P.B.A, Buxhetin e vitit 2024, Paktën Fiskale e të tjera. Këto takime janë zhvilluar në qytet sipas rajoneve përkatëse, në njësitë administrative si, dhe grupet e interesit (subjektet ndërtues, tregtar, si dhe operatorët turistik etj.)

Nëse i referohemi mënyrës së votimit nga këshilltarët konstatohet se për vendimet lidhur me Ndihmën Ekonomike, Emergjencat Civile, Titujt e Nderit, votimi pro ka qënë nga gjithë këshilltarët e pranishëm në mbledhje. Duhet të theksojmë se në tërësi, vota e këshillave edhe për çështje të tjera me karakter social ka qënë unanime.

Ndërkohë vendime të tilla si miratimi i Buxhetit, Paketa Fiskale e ndonjë tjetër janë miratuar me votat e shumicës së këshilltarëve pas diskutimeve dhe debateve të këshilltarëve në komisionet e përhershme dhe mbledhjet përkatëse.

Në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë janë trajtuar edhe problematika të tjera lidhur me

shqetësime të komunitetit ose konstatime të vetë këshilltarëve si çështje të infrastrukturës, të administrimit të territorit etj. Këto problematika i janë përcjellë edhe administratës së bashkisë dhe në këtë drejtim konstatohet se, duhet më tepër angazhim nga administrata me qëllim që, çështje të cilat nuk kërkojnë mjete financiare, të mund të zgjidhen në kohë pa qënë e nevojshme përsëritja e kërkesave.

Në kuadër të transparencës gjatë vitit 2023 të gjitha mbledhjet e Këshillit të Bashkisë, janë trasmetuar në të paktën njërin nga televizionet lokale. Gjithashtu aktet e miratuara nga Këshilli i Bashkisë janë publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Bashkisë si dhe në facebook ku janë të aksesueshme nga çdo i interesuar.

Parë në tërësi puna dhe vendimarrja e Këshillit të Bashkisë që në vitin 2023 ,ka qënë në kushte normale, brenda parashikimeve të dispozitave Ligjore dhe Rregulloreve të miratuara. Ndërkohë, duhet të theksojmë se, duhet të vlerësohet më shumë pjesëmarrja e këshilltarëve në mbledhjet e Komisioneve të Përhershme. Kjo, pasi gjatë kësaj periudhe, janë konstatuar mungesa si dhe ka patur ndonjë rast që nuk është plotësuar kuorumi, e për rrjedhojë, nuk është zhvilluar mbledhja e komisionit. E theksojmë këtë, pasi diskutimi me përgjegjësi i projektvendimeve në komisionet e përhershme, bën më të thjeshtë procedurën vendimmarrëse të Këshillit të Bashkisë.

Veç sa parashtuam më lart, duke qënë se, jemi në nisje të vitit 2024, nga secili prej anëtarve të Këshillit të Bashkisë mund të evidentohen edhe problematika të tjera, të konstatuara, me qëllim që, funksionimi i këshillit dhe vendimarrja e tij, të jenë në standartet e kërkuara nga ligji në funksion të detyrimeve që ka, si organ përfaqësues dhe vendimarrës i Vetqeverisjes Vendore.

SEKRETAR

Daut Zëraj

